

STATUTI I SHOQËRISË
“OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË STERILIZIMIT” SH.A
(OSHS sh.a)

HYRJE

Statuti i Shoqërisë “Operatori i shërbimeve të integruara të sterilizimit” (OSHS) sh.a, është hartuar në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 845, datë 30.12.2025 “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha (OSHS sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”.

KREU I

EMËRTIMI I SHOQËRISË, OBJEKTI DHE MËNYRA E FINANCIMIT

Neni 1

Forma e organizimit

1. Shoqëria “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a është një shoqëri aksionare me ofertë private, që vepron në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar (referuar më tej si “Ligji për shoqëritë tregtare”).
2. Emri i Shoqërisë është “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a., referuar më poshtë si shoqëria aksionare OSHS sh.a..
3. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, përfaqësuar nga Ministri.
4. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2

Selia e shoqërisë, stema dhe vula

1. Selia e shoqërisë aksionare OSHS sh.a.. është në adresën: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë.
2. Shoqëria mund të hapë dhe të mbyllë zyra dhe degë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Shoqëria aksionare OSHS sh.a. ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare, të cilat miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. është me një afat të pakufizuar.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

1. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. është ofrimi kundrejt pagesës të shërbimeve të mëposhtme:
 - a) ofrimin e seteve të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterile;
 - b) furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale;
 - c) trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale;
 - d) ofrimin e shërbimeve të pikave (a), (b) dhe (c) në të gjitha spitalet universitare, rajonale dhe bashkiake;
 - e) menaxhimin dhe administrimin e Stacionit Qendror të Sterilizimit në QSUT;
 - f) ofrimin e instrumenteve kirurgjikale sipas tipologjisë së ndërhyrjes, të paketuara në set individual për çdo pacient;
 - g) menaxhimin e cikleve për ripërpunimin dhe sterilizimin e instrumenteve dhe materialeve të tjera të ripërdorshme;
 - h) ripërpunimin e sterilizimin me avull dhe temperatura të ulta;
 - i) furnizimin me veshje sterile salle dhe materiale të ngjashme njëpërdorimëshe;
 - j) trajtimin e mbetjeve spitalore me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e ambienteve;
 - k) digjitalizimin e menaxhimit, të ndjekjes dhe të raportimit të shërbimeve të integruara të sterilizimit.
2. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a ofron shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kundrejt të gjitha spitaleve publike universitare, rajonale dhe bashkiake në Republikën e Shqipërisë.
3. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit të saj, këtë statut dhe legjislacionin në fuqi,
4. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a për përmbushjen e veprimtarisë së saj mund të nënshkruajë:
 - a) marrëveshje bashkëpunimi me institucione brenda fushës së kompetencave të tyre për ofrimin e asistencës teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) marrëveshje bashkëpunimi me entitete publike apo organizma ndërkombëtarë, me qëllim marrjen e asistencës teknike/ekspertizës së nevojshme për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe institucionale për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
 - c) marrëveshje bashkëpunimi me ekspertë të fushave të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Mënyra e financimit

1. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a financohet nga të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve publike të integruara të sterilizimit nga burime të tjera të ligjshme, si edhe shërbimet ndaj të tretëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të ardhurat përdoren vetëm për ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së saj, duke ruajtur karakterin e shërbimit publik.
2. Lista e tarifave të shërbimeve e shoqëruar me metodologjinë përkatëse miratohet nga Këshilli Mbikqyrës.
3. Të gjitha tarifat e shërbimeve, sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të arkëtohen nga shoqëria aksionare OSHIS sh.a..

Neni 6

Procedurat e prokurimit

1. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, zbaton legjislacionin në fuqi për prokurimet publike, për aq sa ky legjislacion është i zbatueshëm për shoqëritë aksionare me kapital shtetëror.
2. Procedurat e prokurimit zhvillohen në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe eficiencës ekonomike, duke garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit të integruar publik të sterilizimit.

KREU II

KAPITALI DHE AKSIONET

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë aksionare OSHIS sh.a, i nënshkruar dhe i paguar është 200,000,000 (dyqind milionë) lekë, i përbërë nga 200,000 (dyqind mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale 1,000 (një mijë) lekë secili.
2. Kapitali i shoqërisë është 100% shtetëror dhe aksionari i vetëm është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale.

Neni 8

Aksionet

Aksionet e shoqërisë janë të formës nominale dhe të pa transferueshme.

Neni 9
Transferimi i aseteve dhe të drejtave

1. Në përfundim të kontratës së koncesionit për ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit, asetet, pajisjet, infrastruktura dhe çdo e drejtë tjetër që, në përputhje me parashikimet e kontratës së koncesionit dhe legjislacionit në fuqi, i kalojnë Autoritetit Kontraktor, transferohen pa pagesë në favor të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a..
2. Transferimi kryhet në përputhje me kushtet e kontratës së koncesionit, aktet nënligjore përkatëse dhe legjislacionin në fuqi, pa krijuar të drejta ose detyrime shtesë për palët, përtej atyre të parashikuara shprehimisht.

Neni 10
Ndryshimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë apo zvogëlojë kapitalin e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. në zbatim të këtij statuti dhe në përputhje me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me derdhje në para ose me kontribute në natyrë, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Në çdo rast kontributet shoqërohen me një certifikatë për nënshkrimin e tyre ose një raport vlerësimi të përgatitur nga një ekspert i vlerësimit të kontributeve në natyrë.

Neni 11
Transferimi dhe akti i emetimit të aksioneve

1. Aksionet janë të formës nominale dhe lirisht të transferueshme, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Aksionet e shoqërisë emetohen mbi bazën e Aktit të Emetimit, i cili përmban të dhënat e kërkuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe miratohet nga Administratori në lidhje me pjesën e realizuar.
3. Aksionet e reja nuk mund të emetohen para hyrjes në fuqi të zmadhimit dhe miratimit të Aktit të Emetimit.

Neni 12
Regjistri i aksioneve

1. Administratori mban regjistrin e aksioneve, me qëllim pasqyrimin e çdo të drejte të aksionarëve apo palëve të treta mbi aksionet e shoqërisë.
2. Regjistri i aksioneve përmban të dhënat e parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

3. Pronësia mbi aksionet dhe çdo e drejtë e lidhur me to, nuk mund të ushtrohet kundrejt shoqërisë apo të tretëve, përpara regjistrimit të kësaj pronësie në Regjistrin e Aksioneve të mbajtur nga Shoqëria.
4. Aksionari i vetëm pajiset me Regjistrin e Aksioneve.
5. Administratori duhet të raportojë, brenda afateve ligjore, çdo ndryshim të të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Aksioneve.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË OPERATORI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA TË STERILIZIMIT SH.A DHE ADMINISTRIMI

Neni 13

Organet e shoqërisë

1. Shoqëria organizohet sipas sistemit të drejtimit me dy nivele.
2. Organet drejtuese të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme
 - b) Këshilli Mbikqyrës
 - c) Administratori

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme

1. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ministri përgjegjës për Shëndetësinë, në cilësinë e aksionarit të vetëm.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin dhe miratimin e politikave të përgjithshme tregtare dhe të investimit;
 - b) ndryshimin e Statutit;
 - c) emërimin dhe shkarkimin e Adminsitраторit;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - e) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - f) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “d” ;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - h) miratimin e shprëndarjes së fitimeve vjetore;
 - i) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - j) miratimin e blerjes, pjesëtimit apo anulimit të aksioneve;
 - k) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - l) riorganizimin dhe likuidimin e shoqërisë;
 - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n) miratimin e strukturës dhe rregulloreve të brendshme mbi funksionimin e Shoqërisë;

- o) miratimi mbi lëshimin e titujve të borxhit;
 - p) miratimin e strukturave apo subjekteve që ushtrojnë kontrollin e ligjshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë për llogari të saj;
 - q) në kuadër të llogaridhënies, kërkimin e raporteve nga organet e Shoqërisë për çështje specifike ose lidhur me ecurinë e përgjithshme të saj;
 - r) miraton marrëveshje me palë të treta me institucione/subjekte apo organizma ndërkombëtare ku palë është Shoqëria, të cilat nënshkruhen nga Administratori;
 - s) miraton çdo marrëveshje me natyrë financiare me të tretët ku palë është Shoqëria;
 - t) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga nxjerrja e tyre. Regjistrimi realizohet nga Administratori i Shoqërisë.

Neni 15

Rendi i ditës në Asamblenë e Përgjithshme

1. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje për të cilën Asambleja e Përgjithshme merr një vendim.
2. Asambleja e Përgjithshme nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës.
3. Aksionarët kanë të drejtë të përfaqësohen nga një person tjetër, në bazë të një prokure/autorizimi me shkrim. Në çdo rast, prokura/autorizimi jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
4. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të marrin pjesë edhe anëtarët e organeve të tjera drejtuese, Administratori dhe zyrtarë të shoqërisë aksionare "OSHIS" sh.a..
5. Administratori dhe anëtarët e organeve drejtuese nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 16

Protokolli

1. Asambleja e Përgjithshme cakton një Sekretar për mbajtjen e procesverbaleve.
2. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme regjistrohet në procesverbal. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen dhe ruajtjen e procesverbaleve.
3. Në procesverbal shënohen të dhënat në vijim:
 - a. vendi dhe data e mbledhjes;
 - b. rendi i ditës;
 - c. vendimet e marra.
4. Procesverbalit i bashkëngjiten lista e pjesëmarrësve, si dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

5. Procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve nënshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
6. Jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, Sekretari është i detyruar të publikojë kopje të procesverbalit të mbledhjes në faqen e internetit të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a..
7. Organet drejtuese dhe zyrtarët e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. ngarkohen me zbatim e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Këshilli Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, ku një prej tyre caktohet nga ministria përgjegjëse për financat. Anëtarët emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme,
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës udhëhiqen nga parimi i mirëbesimit, duke përfshirë detyrimin, përkujdesin, besnikërinë, konfidencialitetin, integritetin dhe pavarësinë në raport me shoqërinë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a.
3. Shpërblimi për anëtarët dhe kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës propozohet nga Administratori dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen në detyrë për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Një ose më shumë anëtar mund të lirohen/shkarkohen, nga Asambleja e Përgjithshme. Rastet e lirimit/shkarkimit përfshijnë rotacionin, neglizhencën në kryerjen e detyrave, shkeljen e rëndë të rregullave të brendshme dhe cënimin e interesit të shoqërisë “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha, dënimin nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë ose kundravajtje penale, falimentimin, ndalimin, ose pezullimin nga gjykata për ushtrimin e detyrës si nëpunës shtetëror apo në shërbimin publik ose të ushtrisë veprimtarinë apo mjeshtërinë, marrjen pjesë në mënyrë aktive në veprimtari politike gjatë kryerjes së detyrës. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës përfitojnë shpërblim mujor për punën e tyre, i cili caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
3. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës mund të jap dorëheqjen, në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim Asamblenë e Përgjithshme. Dorëheqja hyn në fuqi në kohën e përcaktuar në të.

Neni 19
Kryetari dhe Zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një Kryetar dhe një zëvendës Kryetar, të cilët mbledhin këshillin dhe drejtojnë mbledhjet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre pa të drejtë rizgjedhjeje.
2. Këshilli jashtë anëtarëve të tij mund të emërojë një sekretar i cili përfiton shpërblim mujor.

Neni 20
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës siguron që shoqëria aksionare OSHIS sh.a. gëzon autonomi operationale në veprimtarinë e saj dhe ka këto kompetenca:
 - a) propozon Asamblesë së Përgjithshme Statutin e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. dhe ndryshimet në të;
 - b) propozon Asamblesë së Përgjithshme politikat tregtare të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
 - c) miratimin e tarifave të shërbimit shoqëruar me metodologjinë përkatëse;
 - d) miraton programet e zhvillimit ekonomik të shoqërisë;
 - e) miraton ngritjen e strukturave të tjera të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
 - f) shqyrton dhe kontrollon librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - g) kujdesët që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
 - h) siguron që pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshne në bazë të ligjit apo Statutit, kryhen me saktësi nga shoqëria “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a.;
 - i) krijon komitete të posaçme lidhur me kontrollet e brendshme, përputhshmërinë ligjore dhe etike në shoqërinë aksionare OSHIS sh.a.;
 - j) miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
 - k) identifikon dhe miraton indikatorët kryesor të performancës (KPI), financiar ose jo në lidhje me planin tregtar të Shoqërisë.
 - l) siguron se auditimi i librave dhe regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe i pavarur.
 - m) miraton angazhimet për krjimin e detyrimeve të reja financiare, përpara se këto të paraqiten te aksionari i vetëm për miratimin përfundimtar.
 - n) të krijojë bashkëpunime tregtare afatgjata dhe të propozojë politika të reja.
 - o) ka të drejtë të kontrollojë dhe verifikoj dokumentacionin që gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij.

- p) miraton paraprakisht marrëveshjet e bashkëpunimit përpara miratimit nga Asambleja e Përgjithshme;
- q) miraton rregullat për mënyrën, rastet dhe shpërblimin e pajtimit të këshilltarëve të jashtëm.

Neni 21

Komiteti i Riskut dhe Auditit

1. Komiteti i Riskut dhe Auditit krijohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Më çdo rast, duhet të kryesohet nga një anëtar i pavarur dhe me kualifikim të përshtatshëm.
2. Komiteti do të mbledhet jo më pak se 3 herë në vit.

Neni 22

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen në selinë e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. ose në një vend tjetër sipas kërkesës së drejtuesit të mbledhjes ose të shumicës së anëtarëve.
2. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet rregullisht të paktën 6 herë në vit, si dhe sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë aksionare OSHIS sh.a..
3. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet në një seancë të veçantë me kërkesë të kryetarit apo dy prej anëtarëve të tij, ose me iniciativën e Administratorit.
4. Nëse një anëtar nuk është në gjendje të marr pjesë në një takim personalisht, Këshilli Mbikëqyrës do të lehtësoj lidhjet me mjete të tjera të mundshme, përfshirë telekonferencën ose mjete të ngjashme të komunikimit.
5. Kuorumi për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës arrihet nëse katër nga shtatë anëtarët e tij janë të pranishëm.
6. Një shumicë e anëtarëve të pranishëm, panvarsisht nëse është pjesë e një kuorumi, mund të shtyjnë mbledhjen në një kohë dhe vend tjetër.
7. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës apo me mjete të ngjajshme të komunikimit, me kusht që anëtarët e tjerë të kenë mundësi të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara. Në këtë rast mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet drejtuesi i mbledhjes.

Neni 23

Vendimmarrja

1. Këshilli Mbikëqyrës synon të marrë vendime bazuar në konsensus. Në rast kur nuk mund të arrihet konsensus, Këshilli merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

2. Në rast barazie votash, vota e kryetarit është vendimtare.
3. Punonjësit e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. ngarkohen me zbatimin e vendimeve të marra nga Këshilli i Mbikëqyrjes.

Neni 24

Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron një sekretar, i cili është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve;
 - a) të gjithë takimeve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - b) të gjitha mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe pjesëmarrësve të tjerë në çdo mbledhje.

Neni 25

Administratori

1. Administratori i shoqërisë aksionare OSHIS sh.a. emërohet dhe lirohet nga detyra me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori emërohet në detyrë, për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet.
3. Administratori i raporton Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikëqyrës rregullisht.
4. Administrator emërohet personi që:
 - a) të jetë shtetas shqipëtar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formes së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - d) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vjet akademike ose të barasvlershme me ta, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;
 - e) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në profesion, prej të cilave 3 (tre) vjet në pozicione drejtuese apo menaxheriale në sektorin publik apo privat;
5. Ndaj tij të mos jetë marr masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi. Paga e Administratorit përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26

Kompetencat e Administratorit

1. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë aksionare OSHIS sh.a..

2. Administratori kryen administrimin e zakonshëm të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a., brenda kufijve të vendosur nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, statuti dhe aktet e brendshme dhe kompetencat e deleguara shprehimisht nga Këshilli Mbikëqyrës.
3. Administratori mund të marr pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a..
4. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:
 - a) të administrojë veprimtarinë e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
 - b) të përfaqësoj shoqërinë aksionare OSHIS sh.a. në marrëdhënie me të tretët;
 - c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël;
 - d) të përgatisë dhe të nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për investimin e fitimeve;
 - e) të krijoj një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë menaxhimin dhe performancën;
 - f) të kryej regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) të hartojë dhe/ose të rishikojë tarifat e shërbimeve të integruara të sterilizimit, të bazuara në një metodologji të qartë dhe të justifikuar ekonomikisht, duke marrë në konsideratë kushtet e tregut, kostot reale të ofrimit të shërbimit, standardet përkatëse si dhe nevojën për mbulim të qëndrueshëm financiar. Tarifat dhe metodologjia e përcaktimit të tyre hartohen në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe eficiencës ekonomike, dhe i propozohen për miratim Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme.
 - h) të raportoj përpara organeve drejtuese për zbatimin e politikave, planeve të punës dhe projekteve të investimit;
 - i) të siguroj zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit Mbikëqyrës, legjislacionit dhe akteve të brendshme të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
 - j) të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të organeve drejtuese të shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.;
5. Administratori mund të kërkoj angazhimin e këshilltarëve të jashtëm apo ndihmës të jashtëm, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi, duke ja paraqitur propozimet Këshillit Mbikëqyrës.

TITULLI IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Viti financiar dhe ndarja e dividendëve

1. Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, shpërndahen si më poshtë vijon:

- a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të nënshkruar;
 - b) pjesa e mbetur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ri investohet në shoqërinë aksionare OSHIS sh.a. ose në fonde të tjera rezervë, sipas parashikimeve në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendos që fitimet të ri investohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali, në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe me politikën për dividendët.

Neni 28

Kontabiliteti

1. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a. mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Drejtori dhe Këshilli Mbikëqyrës përgatisin raportin e veprimtarisë, inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
3. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarte ndërkombëtare të kontabilitetit, sipas ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare.

Neni 29

Audituesit ligjorë

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë auditues ligjor të jashtëm e të pavarur, të cilët kanë fituar këtë titull sipas ligjit.
2. Audituesit ligjorë kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 30

Prishja, ndarja dhe bashkimi

1. Shoqëria aksionare OSHIS sh.a. mund të prishet, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
2. Me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme vendos për ndarjen, bashkimin, ose prishjen e shoqërisë aksionare OSHIS sh.a.. Prishja, ndarja dhe bashkimi bëhet nga Asambleja e Përgjithshme pas miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 31

Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Administratori, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës dhe çdo person që merr pjesë në mbledhjet e këtyre organeve duhet të ruaj konfidencialitetin për çështjet e trajtuara.

Neni 32

Legjislacioni i zbatueshëm

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat Shqiptare.

Neni 34

Dispozita përfundimtare

Çështjet, të cilat nuk parashikohen shprehimisht nga ky statut, rregullohen nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Tiranë më, ____ . ____ . 2026

**AKSIONARI THEMELUES I VETËM
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

EVIS SALA

